



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALËSI E MADHE  
KËSHILLI

Nr. 192/prot

Koplik më: 2d/ &/ / 2024

**V E N D I M**

*Nr 11 (date 18/01/2024*

Keshilli Bashkiak Malesi e Madhe në mbledhjen e tij te dates 18.01.2024, mbeshtetur në aktin normativ nr 3 date 15.03.2020 neni 5, me propozim të Kryetarit të Bashkise,në mbeshtetje të Ligjit nr.139/2015.”Per veteqeverisjen vendore”neni 9 pika 1.7/a,te Ligjit 112/2013”Per dekoratat,titujt e nderit,medaljet dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqiperise”seksioni 3 neni 14,neni 15 pika 1/a,pika 2/b.neni 16/1.

VKM Nr.861 date 10.12.2014 Per miratimin e rregullave të holiesishme për funksionimin e komisioneve për dlienen e medaljeve dhe titujve vendor te nderit në Republikën e Shqiperise.

**V E N D O S I**

1. T'i akordoje titullin “Qytetar Nderi ”Z. Gjok Luli (Lakaj) me motivacionin:

“Per punën dhe perkushtimin e tij si nje qytetarë bashkekoliore e me ndjenja të medlia atdhedashurie. Studiues, publicist, botues e promovues, hartues tekste kengesh etj.me karakter historik, etno-kulturore,artistik etj. duke lartësuar kurdohere treven tone Malesi e Madhe e më gjerg“.

2. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori i Sherbimeve te Brendshme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere

KRYETAR

Ilir Halaj

SEKRETAR

Emirjan Hasmujaj

Miratuarme 18.01.2024

Vota Pro 16

Vota Kunder 10

Vota Abstenim 3

Zbardhur me date 19.01.2024





**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA MALESIE MADHE**

Nr. [SA].prot

Koplik mg: /7/Q/2024

**Keshillit te Bashkise Malesi e Vladh**  
**Propozim për dhenie titulli “ Qytetare Nderi “ i Bashkise Malesi e**  
**Madhe z. Gjok Luli (Lakaj)**



Gjok Luli (Lakaj) lindi me 19 Qershor 1949 në Bajze, te Njesise Administrative Kastrat, Bashkia Malesi e Madhe. Perfundoj arsimin 8-vjegare në Shkollën "Prek Gjoni" Bajze. E më pas u diplomua agronom i mesëm me nota të shkëlqyera. Edhe fillimet e punës së tij i ka pikerisht në fushën e agronomisë. Me pas ka kryer detyrën e Shefit të Transporteve në ish-kooperativen Bajze. Gjithashtu Gjok Luli është shquar për pjesmarrje në aktivitete me karakter etno-kulturore, artistik e sportiv duke shkruar e perkrahur më së miri ruajtjen dhe promovimin e traditave më të mira të malesorit me vyrtyte të larta cilësi këto që e dallonin falë dëshirës e pasionin për librin e historinë e Malesisë së Madhe e Shqipërisë.

Duke qënë një njeri me shpirt demokratik organizon me bashkevendas të tjerë në vitin 1989 hapjen e portës (klonit shtetërore) në Mokset. Duke qënë një besimtarë i denjë me 11 Netore 1990 merr pjesë në hapjen e meshës së parë ku lexon pjesë të dashurisë për të madhin Zot.

Vitet 90 Gjokën e gjejnë në krye të Levizjeve Demokratike për të ndryshuar regjimin komunist që kishte pllakosur vendin pas 1944 e deri në 1990. Me 2 Janarë 1991 krijohet PD në Bajze ku ai ishte ndër kryesoret e saj. Me 19 Shkurt 1991 organizon meetingun e parë të PD-së. Për këtë kontribut ai zgjidhet në organet drejtuese të Partisë Demokratike që vetë ishte ndër nismetaret e parë të saj. Ai shquhej për kulturën demokratike, tolerancën dhe vendosjen e meritokracisë në drejtim të subjektit politik por edhe në vendosjen e kuadrove drejtues dhe mbrojtjen e njerezve të ndershëm e patriot. Duke qënë një njohës i mirë i historisë e kultures malesore ai del me librin e parë në vitin 1999 "Kastrati" një studim për këtë bajrak të njohur të trevës tone e më gjere. Falë pasionit për etno-kulturën e artin malesore e më gjere ai ndjek fushën e krijimtarisë ku shumë kenge, emisione promovuese, gazetarise etj. mbajnë "vulën" e tij për të cilën të gjithë në malesoret e më gjere ndihemi krenarë.

Prej vitesh ai është në pension por pa e ndërprerë aktivitetet e tij shoqërore në dobi të gjithë komunitetit bajzjanë, malesore e më gjere duke qënë një promovues e gojëmbel sig e don edhe tradita e trevës tone duke u rreshtuar me njerezit me potenciale.

Për gjitha sa thamë më lartë i propozohet Keshillit Bashkiak Malesi e Madhe ti jepet titulli " Qytetarë Nderi " i Bashkisë Malesi e Madhe me

motivacion:

*"Për punën dhe perkushtimin e tij si një qytetarë bashkekohorë e me ndjenjë të medha atdhetdashurie. Studiues, publicist, botues e promovues, hartues tekste këngesh etj. me karakter historik, etno-kulturore, artistik etj. duke lartësuar kurdoherë trevën tone Malesi e Madhe e më gjere".*

